

Shërbimi i
Sekretariatit
Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE



Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____/____/2025

Lënda: Depozitim projektligji.

Drejtuar: Z. Niko PELESHI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 78, 81 pika 1, 83 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim projektligjin **“Për disa shtesa në ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të ndryshuar”**.

Ju faleminderit.

DEPUTETI PROPOZUES

Zamira Simoj
Zamira Simoj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2025

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9131, DATË 8.9.2003, “PËR RREGULLAT E ETIKËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

Transparenca dhe shmangia e konfliktit të interesit në ndërveprimet me palë të treta

1. Nëpunësit publikë që kanë funksione vendimmarrëse gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si dhe personat që ushtrojnë funksione të larta publike, përfshirë deputetët dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, në ushtrimin e detyrës së tyre, veprojnë në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme në çdo komunikim apo ndërveprim me persona fizikë apo juridikë që përfaqësojnë ose promovojnë interesa të veçanta për vendimmarrje në institucionet publike.

2. Çdo kontakt ose takim që ka për qëllim ndjekjen e një interesi të veçantë deklarohet pranë institucionit përkatës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga zhvillimi i tij. Deklarata

përmban të paktën datën, temën dhe pjesëmarrësit, pa përfshirë të dhëna konfidenciale apo personale.

3. Institucionet e administratës publike krijojnë dhe administrojnë një regjistër të deklarimeve sipas pikës 2 të këtij neni. Regjistri përmban të dhëna të përgjithshme dhe bëhet publik në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Neni 2

Në nenin 21 shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

“Brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton procedurat dhe formatin për deklarimin dhe publikimin e takimeve e kontakteve me përfaqësues të interesave private”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

NIKO PELESHI

RELACION PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9131, DATË 8.9.2003, “PËR RREGULLAT E ETIKËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është forcimi i parimeve të transparencës, përgjegjshmërisë dhe integritetit në administratën publike, përmes vendosjes së detyrimit për deklarimin e kontakteve dhe takimeve me përfaqësues të interesave private. Objektivi kryesor është parandalimi i çdo forme ndikimi të papërshtatshëm apo konflikti interesi në proceset e vendimmarrjes publike, duke siguruar një raportim të qartë, të strukturuar dhe transparent të ndërveprimeve midis nëpunësve publikë dhe palëve të treta që përfaqësojnë interesa të veçanta. Ky angazhim është plotësisht në përputhje me rekomandimet e GRECO për Shqipërinë dhe me standardet ndërkombëtare në fushën e integritetit publik.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji synon të plotësojë boshllëqet ekzistuese në kuadrin ligjor që rregullon etikën dhe integritetin në administratën publike, duke futur dispozita të posaçme për rritjen e transparencës së ndërveprimeve midis zyrtarëve publikë dhe subjekteve private me interesa të veçanta. Legjislacioni aktual nuk parashikon një detyrim të qartë për deklarimin e takimeve apo kontakteve të tilla, çka krijon hapësirë për perceptime negative dhe përfshirje të paformalizuar në proceset e vendimmarrjes.

Përmes këtij projektligji, parashikohet krijimi i regjistrave publikë të deklarimeve, të cilët do të mundësojnë kontroll më të madh publik dhe institucional mbi këto ndërveprime, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien. Ky mekanizëm synon forcimin e integritetit institucional, rritjen e besimit të publikut tek institucionet shtetërore dhe sigurimin e zbatimit të rekomandimeve të Raundit të V-të të Vlerësimit të GRECO për Shqipërinë.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me nenet 81, 83 pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Parimet e tij janë të përafruara me praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e etikës dhe transparencës në administratën publike.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim të legjislacionit me *acquis* të Bashkimit Evropian, ndaj nuk ka vlerësim të shkallës së përafrimit.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga dy dispozita. Ai sjell dy ndryshime thelbësore në Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", me synimin për të rritur transparencën, për të shmangur konfliktin e interesit dhe për të forcuar integritetin në proceset e vendimmarrjes publike.

Së pari, projektligji parashikon shtimin e një neni të ri 5/1, i cili vendos një detyrim të qartë dhe të unifikuar për deklarimin e çdo takimi ose kontakti të zhvilluar nga nëpunësit publikë që kanë funksione vendimmarrëse gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, deputetët, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe çdo person tjetër që ushtron funksione të larta publike, me përfaqësues të interesave private. Ky nen adreson një boshllëk të rëndësishëm në kuadrin ligjor aktual, i cili nuk parashikon një mekanizëm të posaçëm për evidentimin dhe publikimin e ndërveprimeve të kësaj natyre.

Neni i ri 5/1 përcakton se:

- Çdo kontakt apo takim që ka për qëllim ndjekjen ose promovimin e një interesi të veçantë në proceset e vendimmarrjes publike duhet të deklarohet brenda 15 ditëve pranë institucionit përkatës.
- Deklarimi duhet të përmbajë të paktën datën, temën dhe pjesëmarrësit, duke përjashtuar çdo të dhënë konfidenciale ose personale.
- Institucionet e administratës publike detyrohen të krijojnë dhe administrojnë një regjistër publik të deklarimeve, i cili publikohet në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Me këtë ndërhyrje, projektligji synon të garantojë transparencën e ndërveprimeve mes sektorit publik dhe aktorëve privatë, të minimizojë rreziqet e ndikimit të papërshtatshëm dhe të forcojë përgjegjshmërinë institucionale. Kjo masë është gjithashtu në përputhje të

plotë me rekomandimet e GRECO, të cilat kërkojnë forcim të mekanizmave të raportimit dhe hapjes së proceseve të ndërveprimit me palë të treta.

Po ashtu, parashikohet shtimi i një paragrafi të ri në nenin 21, i cili ngarkon Këshillin e Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të miratojë formatin dhe procedurat për deklarimin dhe publikimin e takimeve.

Nëpërmjet këtyre dy propozimeve, projektligji synon të krijojë një mekanizëm të qëndrueshëm dhe transparent, për forcuar integritetin e administratës publike dhe për të rritur besimin e publikut në vendimmarrjen publike.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen të gjitha autoritetet publike që janë subjekt i ligjit për etikën në administratën publike, si dhe Këshilli i Ministrave për miratimin e aktit nënligjor në zbatim të tij.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar me nismën e një deputeti.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare.